



Pasqyrat financiare dhe Raporti i Audituesit të  
Pavarur

SGS Automotive Albania sh.p.k

31 dhjetor 2011

# Përmbajtja

|  | <b>Faqe</b> |
|--|-------------|
| Raporti i audituesit të pavarur          | 1           |
| Pasqyra e pozicionit financiar           | 3           |
| Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse | 4           |
| Pasqyra e ndryshimeve në kapital         | 5           |
| Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare   | 6           |
| Shënimet e pasqyrave financiare          | 7           |





# Grant Thornton

An instinct for growth™

## Raporti i Audituesit të Pavarur

Grant Thornton Albania sh.p.k  
Rr. Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D  
Shkalla B, Kati 1  
Tirana  
Albania

T +355 4 22 74 832  
F +355 4 22 56 560  
[www.grant-thornton.com.mk](http://www.grant-thornton.com.mk)

Për drejtimin dhe pronarin e

SGS Automotive Albania sh.p.k

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te SGS Automotive Albania sh.p.k (më poshtë referuar si “Shoqëria”), te cilat përbëhen nga Pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2011, dhe Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyra e ndryshimeve në kapital, Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimet e tjera shpjeguese.

### *Përgjegjësia e drejtimit për pasqyrat financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshme aq sa drejtimi i konsideron të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë nga gabimet apo mashtrimet.

### *Përgjegjësia e audituesit*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidence auditimi në lidhje me shumat dhe informacionet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve të anomaliave materiale në pasqyrat financiare si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedura auditimi të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllim që të shprehe një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.



Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme dhe shërben si bazë për opinionin tonë të auditimit.

### *Opinion*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë më 31 dhjetor 2011, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin, në përputhje me Standartet Ndërkombetare të Raportimit Financiar.

Ky raport është përkthim i versionit origjinal në anglisht, në rast mospërputhje midis këtyre dy raporteve, përparësi ka ai në gjuhën angleze.

Grant Thornton Albania sh.p.k

*Grant Thornton Albania Shtp.*

Tiranë, Shqipëri  
5 shtator 2012



Pasqyrat Financiare  
31 dhjetor 2011

## Pasqyra e pozicionit financiar

|  | Shënime | 31 dhjetor<br>2011<br>Lek | 31 dhjetor<br>2010<br>Lek |
|--|---------|---------------------------|---------------------------|
| <b>Aktive</b>                            |         |                           |                           |
| <b>Aktive afatgjata</b>                  |         |                           |                           |
| Aktive afatgjata materiale               | 6       | 571,279,697               | 606,568,235               |
| Aktive afatgjata jo-materiale            | 7       | 7,899,965                 | 12,731,209                |
|  |         | <b>579,179,662</b>        | <b>619,299,444</b>        |
| <b>Aktivët afatshkurtra</b>              |         |                           |                           |
| Inventari                                | 7       | 3,687,137                 | 3,894,300                 |
| Llogari të arkëtueshme                   | 8       | 20,472,833                | 84,250,429                |
| Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre  | 9       | 116,919,932               | 27,253,641                |
|  |         | <b>141,079,902</b>        | <b>115,398,370</b>        |
| <b>Totali i aktivitet</b>                |         | <b>720,259,564</b>        | <b>734,697,814</b>        |
| <b>Kapitali aksionar</b>                 |         |                           |                           |
| Kapitali aksionar                        | 10      | 190,000,100               | 100                       |
| Fitimi i pashpërndarë                    |         | (33,845,887)              | (38,762,582)              |
|  |         | <b>156,154,213</b>        | <b>(38,762,482)</b>       |
| <b>Detyrimet</b>                         |         |                           |                           |
| <b>Detyrimet afatgjata</b>               |         |                           |                           |
| Huatë                                    | 11      | -                         | 238,376,202               |
|  |         | -                         | <b>238,376,202</b>        |
| <b>Detyrimet afatshkurtra</b>            |         |                           |                           |
| Huatë                                    | 11      | 499,981,275               | 451,151,669               |
| Llogari te pagueshme                     | 12      | 64,124,076                | 83,932,425                |
|  |         | <b>564,105,351</b>        | <b>535,084,094</b>        |
| <b>Totali i detyrimeve</b>               |         | <b>564,105,351</b>        | <b>773,460,296</b>        |
| <b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b> |         | <b>720,259,564</b>        | <b>734,697,814</b>        |

Këto pasqyra financiare janë aprovuar në 29 qershor 2012 dhe janë firmosur në emër të:

Alexandros Michail  
Drejtor i Përgjithshëm



Mirketa Puriqi  
Drejtoreshë Finance

Shiko shënimet shoqëruese të pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare  
31 dhjetor 2011

## Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

|  | Shënime | Viti i mbyllur me 31 dhjetor<br>2011<br>Ne Lek | 2010<br>Ne Lek      |
|--|---------|--|---------------------|
| <b>Të ardhura operative</b>                            |         |  |                     |
| Të ardhura   | 14      | 514,936,042                                    | 330,865,567         |
| <b>Minus: Shpenzimet Operative</b>                     |         |  |                     |
| Materiale te përdorura                                 | 15      | (14,912,567)                                   | (11,811,902)        |
| Shpenzime personeli                                    | 16      | (146,756,227)                                  | (123,630,492)       |
| Zhvlerësim dhe amortizim                               | 6,7     | (102,120,757)                                  | (30,590,400)        |
| Shpenzime te tjera operative                           | 17      | (178,446,778)                                  | (143,415,019)       |
| <b>Fitimi operativ</b>                                 |         | <b>72,699,713</b>                              | <b>21,417,754</b>   |
| Te ardhurat financiare                                 |         | 860,976  | 15,815              |
| Shpenzimet financiare                                  |         | (57,654,671)                                   | (40,272,447)        |
| (Shpenzimet) financiare, neto                          | 18      | (56,793,695)                                   | (40,256,632)        |
| <b>Fitimi para tatimit</b>                             |         | <b>15,906,018</b>                              | <b>(18,838,878)</b> |
| Shpenzimi për Tatim Fitimin                            | 19      | (10,989,323)                                   | (1,929,057)         |
| <b>Fitimi neto për vitin</b>                           |         | <b>4,916,695</b>                               | <b>(20,767,935)</b> |
| <b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>           |         | -  | -                   |
| <b>Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin</b> |         | <b>4,916,695</b>                               | <b>(20,767,935)</b> |

Shiko shënimet shoqëruese të pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare  
31 dhjetor 2011

## Pasqyra e ndryshimeve në kapital

|  | Kapitali aksionar  | Fitime te<br>pashpërndara | Në Lek<br>Totali    |
|--|--------------------|---------------------------|---------------------|
| Me 01 janar 2011   | 100                | (38,762,582)              | (38,762,482)        |
| Transaksione me pronarët                                     | 190,000,000        | -                         | 190,000,000         |
| Fitimi i vitit   | -                  | 4,916,695                 | 4,916,695           |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse                        | -                  | -                         | -                   |
| <b>Totali i te ardhurave<br/>gjithëpërfshirëse për vitin</b> | <b>-</b>           | <b>4,916,695</b>          | <b>4,916,695</b>    |
| <b>Me 31 dhjetor 2011</b>                                    | <b>190,000,100</b> | <b>(33,845,887)</b>       | <b>156,154,213</b>  |
| Me 01 janar 2010   | 100                | (17,994,647)              | (17,994,547)        |
| Transaksione me pronarët<br>(Humbja) e vitit                 | -                  | -                         | -                   |
|  | -                  | (20,767,935)              | (20,767,935)        |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse                        | -                  | -                         | -                   |
| <b>Totali i te ardhurave<br/>gjithëpërfshirëse për vitin</b> | <b>-</b>           | <b>(20,767,935)</b>       | <b>(20,767,935)</b> |
| <b>Me 31 dhjetor 2010</b>                                    | <b>100</b>         | <b>(38,762,582)</b>       | <b>(38,762,482)</b> |



Pasqyrat Financiare  
31 dhjetor 2011

## Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare

|   | Shënime   | 2011<br>L.ek        | 2010<br>L.ek         |
|---|-----------|---------------------|----------------------|
| <b>Flukset monetare nga aktiviteti operativ:</b>                      |           |                     |                      |
| Fitimi (humbje) pas tatimit   |           | 4,916,695           | (20,767,935)         |
| <i>Rregullime për:</i>  |           |                     |                      |
| Zhvlerësim dhe amortizim  | 6,7       | 102,120,757         | 30,590,400           |
| Të ardhura nga interesi   | 18        | (3,272)             | (15,815)             |
| Shpenzime Interesi  | 18        | 51,605,861          | 34,565,405           |
| Shpenzimi i tatimit mbi fitimin                                       | 19        | 11,010,821          | 1,929,057            |
| <b>Fitimi Operativ para ndryshimeve ne kapitalin qarkullues</b>       |           | <b>169,650,862</b>  | <b>46,301,112</b>    |
| Ulja / (rritja) në inventarë  |           | 207,163             | (2,305,807)          |
| Ulja / (rritja) në llogaritë e arkëtueshme                            |           | 63,777,596          | (68,754,776)         |
| (Ulja) / rritja në llogaritë e pagueshme                              |           | (25,999,557)        | 18,421,244           |
|   |           | 207,636,064         | (6,338,227)          |
| Interes (i paguar)  |           | (51,605,861)        | (3,086,862)          |
| Tatim fitimi (i paguar)   |           | (4,819,613)         | (48,000)             |
| <b>Mjete monetare neto nga (të përdorura) në aktivitetin operativ</b> |           | <b>151,210,590</b>  | <b>(9,473,089)</b>   |
| <b>Flukse monetare nga aktiviteti investues:</b>                      |           |                     |                      |
| Blerje e aktiveve afatgjata materiale                                 | 6         | (61,967,744)        | (419,384,513)        |
| Blerje e aktiveve afatgjata jo-materiale                              | 7         | (33,231)            | -                    |
| Interes i arkëtuar  |           | 3,272               | 15,815               |
| <b>Mjete monetare neto (te përdorura) në aktivitetin investues</b>    |           | <b>(61,997,703)</b> | <b>(419,368,698)</b> |
| <b>Flukse monetare nga aktiviteti financues</b>                       |           |                     |                      |
| Dividend i paguar   |           | 190,000,000         | -                    |
| Ripagimi i huave, neto  |           | (189,546,596)       | 420,505,971          |
| <b>Mjete monetare neto (të përdorura) në aktivitetin financues</b>    |           | <b>453,404</b>      | <b>420,505,971</b>   |
| Rritja/ (ulja) neto ne mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre         |           | 89,666,291          | (8,335,816)          |
| Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre ne fillim te vitit             |           | 27,253,641          | 35,589,457           |
| <b>Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre në fund të vitit</b>        | <b>10</b> | <b>116,919,932</b>  | <b>27,253,641</b>    |

# Shënimet e Pasqyrave Financiare

## 1 Të përgjithshme

SGS Automotive Albania sh.p.k (“Shoqëria”) është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që operon në Republikën e Shqipërisë dhe është regjistruar në 10 shtator 2009 në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Adresa e zyrës qendrore të regjistruar në Tiranë, është Rr. Irfan Tomini, Pallati G & P, Kati I-rë .

Mëma e shoqërisë është SGS Societe General De Surveillance s.a., Gjenevë Zvicër , e cila ne 31 dhjetor 2011 dhe 2010 zotëron 100% të totalit të kapitalit aksionar.

Aktiviteti kryesor i biznesit të shoqërisë është inspektimi teknik i të gjithë mjeteve automotivë për një periudhë 10 vjeçare siç përshkruhet në kontratën e koncesionit mes SGS Societe General De Surveillance s.a. dhe Ministrisë së Transportit dhe Punëve Publike të Shqipërisë e cila vepron si autoriteti kontraktual. Shoqëria operon në tregun vendas dhe ka 15 degë te hapura.

Në 31 dhjetor 2011, shoqëria ka të punësuar 118 punonjës (në 31 dhjetor 2010: 113).

### Marrëveshja e Koncesionit

#### *Përshkrimi i marrëveshjes*

Sipas nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 21 të ligjit shqiptar nr 9663 “Ligji i Koncesioneve” (i amenduar) datë 18 dhjetor 2006, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr 27, i titulluar “Mbi aprovimin e rregullave të vlerësimit dhe garantimit të koncesioneve”, datë 19 janar 2007, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr 643, i titulluar “Për zgjedhjen e autoritetit kontraktual për dhënien e koncesionit të kontrollit të detyrueshëm teknik për mjete dhe rimorkiot e tyre në Republikën e Shqipërisë, për (i) projektimin, financimin, rehabilitimin, testimin, përdorimin, dhe mirëmbajtjen e Qendrave ekzistuese të Kontrollit Teknik (QKT) dhe pajisjeve ekzistuese gjatë periudhës së koncesionit; (ii) projektion, financimin, ndërtimin, testimin, pronësinë, përdorimin dhe transferimin e projektit te qeverisë Shqiptare të përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe Punëve Publike të Shqipërisë pjesë e marrëveshjes së koncesionit datë 3 shtator 2009 (“Marrëveshja e Koncesionit”).

#### *Periudha e koncesionit:*

Koncesioni është dhënë për një periudhë 10 vjeçare duke filluar nga data efektive (3 shtator 2009).

#### *Objekti i koncesionit:*

Autoriteti kontraktues i jep Koncesionarit të drejtën të :

1. Te projektojë, financojë, rehabilitojë, testojë, mirëmbajë dhe të përdorë QKT ekzistuese dhe pajisjet e lidhura për periudhën e koncesionit.

Pasqyrat financiare  
31 dhjetor 2011  
Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)  
Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)  
Shumat janë të shprehura në lek përveç se kur specifikohet ndryshe

2. Të projektojnë, financojnë, ndërtojnë, testojnë, përdorin, mirëmbajnë dhe në fund të periudhës së koncesionit të transferojnë QKT dhe pajisjet e lidhura me to tek autoriteti kontraktues.
3. Të ofrojnë klientëve Shërbimin e Kontrollit Teknik të Detyrueshëm për automjetet. Të ofrojnë shërbim profesional në përputhje me këtë marrëveshje, me manualin e kontrollit dhe me legjislacionin në fuqi.

#### *Dorëzimi i QKT*

1. Në fund të periudhës së marrëveshjes Koncesionari duhet të kthejë QKT-te ekzistuese pranë autoritetit kontraktues.
2. Në fund të periudhës së marrëveshjes Koncesionari duhet të kthejë pranë autoritetit kontraktues QKT-te e reja të ndërtuara dhe pajisjet që lidhen me to. Ky transferim nuk do të shoqërohet me asnjë pagesë nga autoriteti kontraktues për koncesionarin.
3. Kontraktuesi duhet të transferojë gjithashtu edhe pajisjet elektronike dhe kompjuterike, ndërtimet në proces, licencat e programeve kompjuterike, të drejta kontraktuale, regjistrime kontabël etj.

#### *Tarifa koncesionare*

Koncesionari duhet t'i paguajë autoritetit kontraktual një tarifë prej 5% të të ardhurave vjetore (para tatimit mbi fitimin).

Tarifa e koncesionit duhet të llogaritet dhe paguhet çdo muaj duke filluar nga data efektive – 3 shtator 2009.

#### *Investimi i Koncesionarit*

Koncesionari duhet të kryejë një investim në mënyrë që të mundësojë ofrimin e shërbimit të kontrollit teknik. Investimi duhet të jetë 561,003,000 Lekë prej të cilave 267,402,000 Lekë duhet të kryhet për pajisje elektro-mekanike dhe kompjutera.

#### *Ri-investimi i Koncesionarit*

Koncesionari ka detyrimin të mirëmbajë pronën nën koncesion. Koncesionari duhet të investojë në 3 vitet e fundit të marrëveshjes një shumë prej 172,000,000 Lekë që përbën 30.7% e investimit të Koncesionarit.

Nëse Koncesionari nuk ka kryer një ri-investim të plotë përpara përfundimit të marrëveshjes së koncesionit, atëherë duhet t'i paguhet diferenca autoritetit kontraktues.

#### *Tarifa të tjera*

Koncesionari duhet t'i paguajë 5,610,030 Lekë agjencisë së koncesioneve. (1% e investimit)

## **2 Bazat e përgatitjes dhe e përputhshmërisë**

### **(a) Baza e Përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e publikuara nga Komisioni i Interpretimeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KINRF") të BSNK. Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit



Pasqyrat financiare  
 31 dhjetor 2011  
 Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)  
 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)  
 Shumat janë të shprehura në lek përveç se kur specifikohet ndryshe

të specifikuar nga SNRF për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e vlerësimit janë përshkruar në mënyrë më të qartë në politikat kontabël të paraqitura si më poshtë.

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

(c) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lekë, e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

(d) Përdorimi i gjykimit dhe i vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi i shoqërisë të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që mund të ndikojnë në aplikimin e politikave si dhe vlerave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet kryesore janë rishikuar në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në çdo periudhë të ardhshme në të cilën mund të ketë ndikim. Referohu shënimit 5 të pasqyrave financiare lidhur me vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël.

### **3 Politika të rëndësishme kontabël**

#### **3.1 Adoptimi i standardet e reja dhe të rishikuara**

(a) Standardet e reja dhe ato të ndryshuara të adoptuara nga ana e shoqërisë

Përmirësimet në SNRF 2010 sollën disa amendime të vogla në një numër të caktuar të SNRF – ve. Adoptimi i këtyre amendimeve ndaj standardeve dhe interpretimeve ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim në politikat kontabël të shoqërisë.

(b) Standardet, interpretimet dhe amendimet e bëra në lidhje me standardet nuk janë efektive për vitin financiar që fillon në 1 janar 2011 dhe që nuk janë adoptuar më përpara nga ana e shoqërisë.

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja, amendime dhe interpretime të standardeve ekzistuese ishin publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) por që nuk janë bërë akoma efektive dhe nuk kanë qenë të adoptuara më parë nga Shoqëria.

Drejtimi i Shoqërisë parashikon që të gjitha deklaratimet do të adoptohen në politikat kontabël të shoqërisë në momentin që këto deklaratime do të bëhen efektive. Informacionet në lidhje me standardet e reja, ndryshimet dhe interpretimet që priten të jenë të rëndësishme për pasqyrat financiare të Shoqërisë parashtrihen si më poshtë. Disa standarde dhe interpretime të tjera që janë publikuar nuk priten që të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të shoqërisë.

- **SNRF 9 Instrumentet Financiare (SNRF 9)** – BSNK synon të zëvendësojë SNK 9 “Instrumentet Financiare”: Njohja dhe matja në tërësinë e tyre”. SNRF 9 po publikohet me faza. Deri tani, seksionet në lidhje me njohjen, klasifikimin, matjen dhe mosnjohjen e aktiveve financiare dhe detyrimeve janë publikuar. Këto seksione do të jenë efektive që nga 1 janar 2015. Disa seksione në lidhje me metodat e zhvlerësimit dhe me kontabilitetin mbrojtës janë në zhvillim e sipër. Drejtimi i shoqërisë ka ende për të vlerësuar ndikimin e këtij standardi të ri në pasqyrat financiare. Megjithatë, drejtimi i shoqërisë nuk do të implementojë SNRF 9 deri në momentin që të gjitha seksionet do të publikohen në mënyrë që të vlerësojnë ndikimin e të gjitha ndryshimeve.

## Pasqyrat financiare

31 dhjetor 2011

Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Shumat janë të shprehura në lek përveç se kur specifikohet ndryshe

- **Standardet e konsoliduara** - Një paketë me standardet e konsoliduara është efektive për tu përdorur që nga 1 janar 2013 ose pas kësaj date. Informacioni në lidhje me këto standarde parashtrohet si më poshtë. Drejtimi i shoqërisë duhet të vlerësojë ndikimin e këtyre standardeve të reja dhe të rishikuara në pasqyrat financiare.

SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara (SNRF 10)

SNRF 10 zëvendëson SNK 27 “Pasqyrat Financiare Individuale dhe të Konsoliduara” dhe Komiteti i Interpretimeve të Përhershme (KIP) 12 “Konsolidimi – Shoqëritë për qëllime të veçanta”. Është rishikuar përkufizimi i kontrollit së bashku me udhëzimin shoqëruar për të identifikuar ndonjë interes në degët e Shoqërisë (shoqëri bija). Megjithatë, kërkesat dhe mekanizmat e konsolidimit dhe kontabilitetit për rastet e interesave jo-kontrolluese dhe ndryshimet në kontroll mbeten të njëjtat.

SNRF 11 Marrëveshjet e përbashkëta (SNRF 11)

SNRF 11 zëvendëson SNK 31 “Interesat në Sipërmarrjet e përbashkëta (SNK 31)”.

Ky standard përaftron kontabilitetin nga investitorët me të drejtat dhe detyrimet e tyre në lidhje me marrëveshjet e përbashkëta. Përveç kësaj, opsioni i SNK 31 për të përdorur konsolidimin proporcional në sipërmarrjet e përbashkëta është eliminuar. SNRF 11 tani kërkon përdorimin e metodës së kontabilitetit të kapitalit, e cila përdoret aktualisht për investimet në pjesëmarrje.

SNRF 12 Shënimet shpjeguese në lidhje me interesat në subjektet e tjera. (SNRF 12)

SNRF 12 integron dhe përputh kërkesat për shënimet shpjeguese në lidhje me lloje të ndryshme investimesh duke përfshirë subjekte të strukturuar të pa-konsoliduara. Ky standard paraqet kërkesa të reja për shënimet shpjeguese në lidhje me riskun që një subjekt ekspozohet nga përfshirja në subjektet e strukturuar.

Ndryshime të rëndësishme të SNK 27 dhe SNK 28 “Investimet në Pjesëmarrjet dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (SNK 28)

Tani SNK 27 merret vetëm me pasqyrat financiare individuale. SNK 28 ka si qëllim interpretimin e investimeve në sipërmarrjet e përbashkëta. Megjithatë, metodologjia e kontabilizimit të kapitalit sipas SNK 28 mbetet e pandryshuar.

- **SNRF 13 Matja e vlerës së drejtë (SNRF 13)**- SNRF 13 nuk përcakton se cilat zëra duhet të njihen me vlerë të drejtë por sqaron përkufizimin e vlerës së drejtë dhe jep udhëzime në shënimet shpjeguese në lidhje me matjen e vlerës së drejtë. Ky standard është i aplikueshëm që nga data 1 janar 2013 dhe pas kësaj date. Drejtimi i shoqërisë duhet të vlerësojë ndikimin e këtyre ndryshimeve në pasqyrat financiare.
- **Amendimet i SNK 1 Paraqitja e pasqyrave financiare (SNK 1 Amendimet)**- Amendimet në SNK 1 kërkojnë që shoqëria të grupojë zërat e paraqitura në të ardhurat e tjera përmbledhëse në përputhje me SNRF e tjera: (a)nuk do të riklasifikohen më pas në fitim apo humbje dhe do të riklasifikohen më pas në fitim apo humbje kur të plotësohen kushte të caktuara. Ky ndryshim është i aplikueshëm që nga data 1 korrik 2012 ose pas kësaj date. Drejtimi i shoqërisë pret që ky amendim do të ndryshojë paraqitjen aktuale të zërave në të ardhurat e tjera përmbledhëse, megjithatë nuk do të ndikojë në matjen apo njohjen e këtyre zërave.
- **Amendimet në SNK 19 Përfitimet e Punonjësve (SNK 19 Amendimet)**- Amendimet e SNK 19 përfshijnë një numër të caktuar përmirësimesh të synuara të standardit. Ndryshimet kryesore lidhen me planin e përcaktuar të përfitimeve. Ato:
  - kanë eliminuar “metodën e korridorit” duke i kërkuar shoqërive që të njohin të gjitha humbjet dhe fitimet që kanë rezultuar gjatë periudhës raportuese.
  - kanë përmirësuar paraqitjen e ndryshimeve në aktive dhe detyrime

Pasqyrat financiare  
31 dhjetor 2011  
Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)  
Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)  
Shumat janë të shprehura në lek përveç se kur specifikohet ndryshe

- kanë rritur kërkesat për shënime shpjeguese duke përfshirë informacion në lidhje me planin e përcaktuar të përfitimeve dhe me riskun ndaj të cilit ekspozohen subjektet që marrin pjesë në to.

Versioni i ndryshuar i SNK 19 është efektiv për vitin financiar që fillon nga 1 janar 2013 dhe mbas kësaj date. Drejtimi i shoqërisë duhet që të vlerësojë ndikimin e këtij standardi të rishikuar në pasqyrat financiare të konsoliduara.

### 3.2 Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Humbjet dhe fitimet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e këtyre transaksioneve dhe nga rivlerësimi i zërave monetare në monedhë të huaj me kursin e këmbimit të fundit të vitit njihen në fitim ose humbje.

Zërat jo monetare nuk konvertohen në fund të vitit dhe maten me kosto historike (e konvertuar duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit), përveç zërave jo-monetare të matur me vlerë të drejtë të cilët konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është përcaktuar.

Kurset e këmbimit të rëndësishme në lidhje me Lek-un Shqiptar për një njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit janë paraqitur si më poshtë:

|        | 31 dhjetor 2011 | 31 dhjetor 2010 |
|--------|-----------------|-----------------|
| 1 Euro | 138.93 Lekë     | 138.77 Lekë     |
| 1 USD  | 107.54 Lekë     | 104.00 Lekë     |

### 3.3 Aktivët Afatgjatë materiale

Aktivët afatgjatë materiale mbahen me kosto historike minus zhvlerësimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga rënia në vlerë ,nëse ka. Kostot historike përfshijnë të gjitha shpenzimet që janë direkt të lidhura me blerjen e aktiveve.

Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e lëndës së parë ,punën direkte dhe çdo kosto tjetër të lidhura direkt për të sjellë aktivin në gjendje pune për përdorimin e tyre, koston e çmontimit dhe lëvizjes së aktivitetit dhe rregullimit të vendit në të cilin janë vendosur dhe kapitalizimin e koston së huamarreve.

Kosto e interesat nga huamarret që përdoren për financimin e ndërtimit të aktiveve afatgjatë material janë kapitalizuar gjatë periudhës kohore që është e nevojshme për të kompletuar dhe përgatitur aktivin për përdorim. Shpenzimet e tjera të borxhit janë shpenzuar.

Kostot vijuese përfshihen në vlerën kontabël të aktivitetit ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm atëherë kur pritet me besueshmëri të lartë që në shoqëri do të rrjedhin përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Te gjitha kostot e mirëmbajtjes dhe riparimeve të aktiveve afatgjatë materiale njihen në fitim ose humbje në periudhën financiare kur ato ndodhin.

Zhvlerësimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare të zhvlerësimit sipas normave të përcaktuara për shpërndarjen e koston së aktiveve material afatgjatë përgjatë jetës së tyre të obishme dhe normat e zhvlerësimit të aktiveve afatgjatë materiale janë si më poshtë:



Pasqyrat financiare  
31 dhjetor 2011  
Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)  
Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)  
Shumat janë të shprehura në lek përveç se kur specifikohet ndryshe

|  | 2011   | 2010  |
|--|--------|-------|
| Ndërtesa   | 10%    | 10%   |
| Instalime Teknike  | 20%    | 20%   |
| Mjete transporti   | 20%    | 20%   |
| EDP Pajisje Kompjuterike (Pajisje teknike dhe programe kompjuterike) | 33,3%  | 33,3% |
| Pajisje Zyre   | 20%    | 20%   |
| Tokë   | 11,11% | -     |

Bazuar në marrëveshjen e koncesionit “Aktivet e shoqërisë duhet të dorëzohen pa asnjë kompensim”, drejtimi i përgjithshëm i shoqërisë ka vendosur të zhvlerësojë tokën ( në mënyrë që vlera e mbetur e saj të bëhet 0(zero) në fund te kontratës), duke filluar nga viti 2011 për gjithë periudhën e mbetur prej 9 vitesh deri ne vitin 2019. Përqindja e përdorur për zhvlerësim është si më sipër. Për efekte fiskale , i gjithë shpenzimi i zhvlerësimit të tokës do të kalojë në shpenzime të pazbritshme.

Vlerat e mbartura dhe jetëgjatësia e aktiveve rishikohen, dhe nëse është e nevojshme rregullohen në çdo datë të raportimit të pasqyrave financiare. Në rastet kur vlera e mbetur e aktivit është më e madhe se sa vlera e përlogaritur e rikuperueshme e tij, atëherë ky aktiv duhet të zhvlerësohet menjëherë dhe vlera e tij duhet të jetë sa vlera e përlogaritur e rikuperueshme. Periudha e zhvlerësimit nuk duhet të jetë më e madhe se 10 (dhjetë) vjet, e cila është në të njëjtën kohë edhe periudha operationale e përcaktuar në marrëveshjen e koncesionit.

Fitimi dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit janë të përcaktuara duke krahasuar të hyrat e nxjerrjes jashtë përdorimit me vlerën e mbartur. Diferencat janë të përfshira në fitim ose humbjet e periudhës në të cilën kanë ndodhur. Kur aktivet e rivlerësuara shiten, tepricat e shtuara në rivlerësim kalojnë në fitimet e pashpërndara.

Sic paraqitet në shënimin 1 të pasqyrave financiare, shoqëria operon nën një kontratë koncesioni e cila trajtohet nga KIRFN 12. Shoqëria ka njohur aktivet nën kontratën e koncesionit si aktive afatgjata materiale në përputhje me SNK 16 më 31 dhjetor 2011 dhe 2010. Shoqëria zhvlerëson aktivet afatgjata materiale për periudhën e koncesionit duke përdorur normat e zhvlerësimit në përputhje me KIRFN 12. Në 2012 shoqëria ka vendosur te ndryshojë politikën kontabël në lidhje me aktivet afatgjata materiale në përputhje me IFRIC 12, sipas së cilit aktivet afatgjata materiale do te riklasifikohen si aktive afatgjata jomateriale.

### 3.4 Aktivet Afatgjata jo-materiale

Aktivët afatgjata jo-materiale ,të cilat përfshijnë programe kompjuterike dhe liçensa, mbahen me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga rënia në vlerë (nëse ka). Zhvlerësimi i tyre llogaritet duke përdorur metodën lineare të zhvlerësimit përgjatë gjithë jetës së tyre të dobishme. Jetëgjatësia dhe metoda e amortizimit të aktiveve afatgjata jo-materiale shqyrtohet, në çdo datë të Pasqyrës së pozicionit financiar dhe efektet e ndryshimit merren parasysh në periudhat e ardhshme.

Pasqyrat financiare  
31 dhjetor 2011  
Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)  
Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)  
Shumat janë të shprehura në lek përveç se kur specifikohet ndryshe

### 3.5 Zhvlerësim për aktivet jo-financiare

Vlerat e mbartura për aktivet jo-financiare të shoqërisë, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësimin e tyre. Nëse ndonjë tregues i tillë ekziston atëherë vlera e rikuperueshme e aktivit rivekstruar. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi është më e madhe se vlera e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e vogël se vlera e tij e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet apo grupet e tjera të aktiveve. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të ardhshme skontohen për të sjellë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivit.

Në lidhje me aktivet e tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret në qoftë se ka ndonjë tregues që ky zhvlerësim nuk ekziston më dhe ka pasur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerat e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret deri në masën që vlera kontabël e aktivit nuk e kalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar, neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi, në qoftë se asnjë humbje nga zhvlerësimi nuk është njohur.

### 3.6 Instrumentet Financiare

Shoqëria zotëron vetëm instrument jo-derivativë financiarë të përbërë nga klientë dhe llogari të tjera të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, hua, furnitorë dhe të tjera llogari të pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivativë njihen fillimisht me vlerë të drejtë. Për instrumentet e njohur jo me vlerë të drejtë kostot direkte të atribueshme shkojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç siç është përshkruar si më poshtë. Pas njohjes fillestare njohja e instrumenteve financiare jo-derivativë matet si më poshtë.

Një instrument financiar njihet në qoftë se shoqëria bëhet pjesë e një provizionimi kontraktual mbi instrumentin. Instrumentet financiare pushojnë së njohuri në qoftë se të drejtat kontraktuale të shoqërisë për flukse monetare përfundojnë ose shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë tjetër pa zotëruar me kontroll mbi të ose në mënyrë domethënëse mbi rreziqet dhe përfitimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit të tyre, që do të thotë në datën kur shoqëria angazhohet për të blerë apo shitur aktivin. Detyrimet financiare pushojnë së njohuri në qoftë se detyrimet kontraktuale të shoqërisë përfundojnë ose anulohen.

#### *Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre*

Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë paratë në arkë dhe depozitat rrjedhëse në banka apo investime të tjera likuide afatshkurtra me maturitet 3 ose më pak muaj, për të cilat rreziku i një ndryshimi në vlerën e drejtë është i pakonsiderueshëm, investime të cilat shoqëria i përdor për menaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me koston e tyre të amortizuar.

#### *Llogari dhe të tjera të arkëtueshme*



Pasqyrat financiare  
31 dhjetor 2011  
Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)  
Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)  
Shumat janë të shprehura në lek përveç se kur specifikohet ndryshe

Llogaritë e arkëtueshme janë njohur fillimisht me vlerë të drejtë dhe vlerësuar më pas me kosto të amortizuar pakësuar me humbjet nga zhvlerësimi.

Një provizion për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme njihet kur ka një evidencë objektive që shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledh të gjitha shumat në përputhje me termat e llogarive të arkëtueshme.

Vështirësitë financiare të konsiderueshme të debitorit, mundësia e falimentimit, riorganizimi financiar si dhe pagesat me vonesë janë tregues për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

Shuma e provizionit është diferenca midis vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet me maturitet të shkurtër nuk skontojnë. Vlera kontabël e aktivit zvogëlohet duke përdorur një llogari zhvlerësimi dhe vlera e humbjes njihet në fitim ose humbje. Kur një llogari e arkëtueshme është e pambledhshme, ajo mbyllet duke përdorur llogarinë e zhvlerësimit. Vlerat që mund të rikuperohen në të ardhmen për shumat e njohura si borxh i keq njihen në fitim ose humbje.

#### *Huatë*

Pas njohjes fillestare huatë që mbartin interes janë paraqitur me kosto të amortizuar dhe çdo diferencë ndërmjet koston dhe vlerës së huasë është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë periudhës me bazë interesi efektiv.

#### *Llogari dhe të tjera të pagueshme*

Llogari dhe të tjera të pagueshme ndaj furnitorëve të tjerë janë paraqitur me vlerë të drejtë, rrjedhimisht me koston e tyre të amortizuar.

#### *Njohja e zhvlerësimit për aktivet financiare*

Një aktiv financiar merret në konsideratë për efekt zhvlerësimi në qoftë se ekzistojnë tregues objektive që një ose më tepër ngjarje mund të kenë ndikim negativ në flukset e pritshme të ardhshme që do të gjenerojë ky aktiv.

Një humbje nga zhvlerësimi në raport me një aktiv financiar të matur dhe të amortizuar me kosto llogaritet si diferencë midis vlerës së mbartur dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhme të skontuara me normën e interesit efektiv.

Aktivët financiarë me vlerë të konsiderueshme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Pjesa tjetër e aktiveve financiare grupohen në grupe me karakteristika rreziku të njëjta. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në fitim ose humbje. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret në qoftë se rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi fillestar. Rimarrja bëhet në fitim ose humbje.

### **3.7 Kapitali Aksionar**

Kapitali aksionar konsiston në mjetet monetare të kontribuar nga themeluesit e shoqërisë. Kapitali aksionar paraqitet me vlerën në Lekë të konvertuar me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali aksionar i shoqërisë njihet me vlerë nominale.



Pasqyrat financiare  
31 dhjetor 2011  
Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)  
Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)  
Shumat janë të shprehura në lek përveç se kur specifikohet ndryshe

### 3.8 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përbëhen nga të ardhurat e gjeneruara nga ofrimi i shërbimeve. Të ardhurat maten duke u bazuar në arkëtimet e marra ose të pritshme për tu marrë nga shoqëria për shërbimet e siguruar, me përjashtim të taksave të shitjes, uljeve, dhe zbritjeve nga marrëdhëniet tregtare.

Shoqëria aplikon kriterin e njohjes së të ardhurave siç përshkruhet më poshtë për çdo komponent të identifikueshëm të transaksioneve të shitjeve në mënyrë që të reflektohet thelbi i transaksioneve. Arkëtimet e marra nga këto transaksione janë alokuar në komponentët e veçantë të identifikuar duke marrë parasysh vlerën e drejtë relative të çdo komponenti.

#### *Kryerja e shërbimeve*

Të ardhurat njihen kur shumat e të ardhurave mund të maten në mënyrë të besueshme, mbledhja është e mundshme, kostot e ndodhura apo që priten të ndodhin mund të maten në mënyrë të besueshme dhe kur kriteret për çdo aktivitet të veçantë të shoqërisë janë përmbushur. Këto kritere specifike sipas aktivitetit të njohjes së të ardhurave janë të bazuara në shërbimet e siguruar klientëve dhe në kontratat e çdo rasti.

Duke u bazuar në Kontratën e koncesionit ndërmjet SGS Societe General De Surveillance s.a. dhe Ministrisë së Transportit dhe Punëve Publike, shoqëria është e autorizuar të ofrojë shërbime të kolaudimit të automjeteve siç është parapërcaktuar në marrëveshjen koncesionare.

#### *Të ardhurat nga interesi*

Të ardhurat nga interesi përlogariten në mënyrë të vazhdueshme, bazuar në principlin e mbetur si dhe normën efektive të interesit të aplikueshme.

### 3.9 Përfitimet e punonjësve

#### *Kontributet e detyrueshme për sigurime shoqërore*

Gjatë ushtrimit të aktivitetit operativ, shoqëria kryen pagesa periodike për llogari të punonjësve për pjesën që ligjërisht i takon të paguajë shoqërisë dhe punonjësve për të kontribuar për fondet e detyrueshme të pensioneve sipas rregullimeve të legjislacionit vendas. Kostot e shoqërisë janë përfshirë në llogaritjen e rezultatit të periudhës.

### 3.10 Tatim fitimi i vitit dhe tatim fitimi i shtyre

Shpenzimet për tatim fitimin përfshijnë tatim fitimin aktual dhe tatim fitimin e shtyrë. Shpenzimet për tatim fitimin njihen në fitim ose humbje deri përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera përmbledhëse.

Tatimi mbi fitimin aktual është tatimi i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme duke përdorur normat e taksimit në datën e raportimit dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm të lidhur me vitin e kaluar. Tatimi mbi fitimin i aplikueshëm është 10% e fitimit të tatueshëm.

Tatim fitimi i shtyre njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyre matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato ndryshojnë, duke u bazuar në ligjet që kanë qenë ose janë në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyre njihet në masën që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion për të mbuluar diferencat e përkohshme. Aktivitet tatimor të shtyra

Pasqyrat financiare  
31 dhjetor 2011  
Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)  
Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)  
Shumat janë të shprehura në lek përveç se kur specifikohet ndryshe

rishikohen në çdo date raportimi dhe reduktohen në qoftë se përfitimet tatimore nuk do të jenë më të mundshme për tu realizuar.

### **3.11 Provizionet**

Provizionet njihen kur shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një rrjedhje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të shlyer detyrimin dhe kur mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i vlerës së detyrimit. Nëse efekti është material, provizionet llogariten duke zbritur vlerën e pritshme të mjeteve monetare të ardhshme para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parashë, dhe kur është e nevojshme rrezikun specifik të detyrimit.

Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk është më e mundshme që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin, provizioni anulohet. Provizionet përdoren vetëm për qëllimet e njohura fillimisht. Provizionet nuk njihen për humbje të ardhme operative. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në kontabilitet.

### **3.12 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Aktivët e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet shpjeguese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme. Shuma e një humbje të kushtëzuar njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provizionin, një detyrim njihet në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

### **3.13 Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarë dhe drejtorët e shoqërisë, së bashku me entitete që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme, vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.

### **3.14 Ngjarje pas datës së bilancit**

Ngjarjet pas datës së bilancit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.



Pasqyrat financiare  
31 dhjetor 2011  
Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)  
Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)  
Shumat janë të shprehura në lek përveç se kur specifikohet ndryshe

## 4 Menaxhimi i rrezikut financiar

### 4.1 Faktorët e rrezikut financiar

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare, që përfshijnë rrezikun e kreditit dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave të huaja dhe normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut të shoqërisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizojë efektet potenciale të kundërta mbi performancën e biznesit të shoqërisë.

Menaxhimi i rrezikut kryhet nga drejtimi bazuar në politika të aprovuara dhe procedura që mbulojnë gjithë menaxhimin e rrezikut, si dhe çështje specifike, si rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normës së interesit, rreziku i kreditit, përdorimi i letrave me vlerë të përshtatshme dhe investimi i likuiditetit të tepërt.

### 4.2 Rreziku i tregut

#### Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që vjen si rezultat i ekspozimit në monedha të ndryshme kryesisht në lidhje me Euron. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument për të mbrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur pozicione neto të përshtatshme në çdo monedhë dhe në total dhe të monitorojë operacionet e përditshme.

Vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve financiare të shoqërisë të shprehura në monedhe të huaj është si më poshtë:

|  |     | 2011<br>ne Lek     | 2010<br>ne Lek       |
|--|-----|--------------------|----------------------|
| <b>Aktive financiare</b>               |     |                    |                      |
